

VENDIM
Nr.262, datë 31.3.2010

PËR TARIFËN E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa e shkollimit për studimet në Shkollën e Magjistraturës të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit vetëm një herë, në fillim të ciklit 3-vjeçar të studimeve.
3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha